

SUBJEKTI
“NDERTIM PRODHIM KRUJA” SHPK
NIPT J64102239D

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

| PRODHIMI I MOBILERIVE | |
|---|---|
| ID 11.1 | Prodhim i mobilieve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë. |
| VEPRIMTARI TË TJERA QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E SOLVENTËVE | |
| ID 7.12/I | Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri |

Sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”

VENDNDODHJA: Durrës, Krujë, Lagjja nr.4, rruga Karl Gega,
ndërtesë private, 5 kateshe, zona kadastrale nr. 8621, me
numer pasurie 4/103 dhe 4/313.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

| | |
|--|----|
| 1. PROFILI I OPERATORIT..... | 3 |
| 2. QËLLIMI I RAPORTIT..... | 3 |
| 3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT..... | 3 |
| 4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT..... | 4 |
| 5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT..... | 5 |
| 6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS..... | 7 |
| 7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS..... | 12 |
| 8. MONITORIMI..... | 13 |

1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti “**NDERTIM PRODHIM KRUJA**” SHPK është i regjistruar ne QKB me Formë Ligjore si Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), i pajisur me Nr. Identifikimi **NIPT J64102239D**, me Administrator **Z. Ali Kaloshi**.

Fusha e veprimtarisë së operatorit konsiston në: *Perpunim prodhim pjese kembimi per mobilieri, ndertime civile, industriale, etj. Linja prodhimi te dyshekeve, jorganeve, jastikeve dhe perdeve. Perpunimi i sfungjerit.*

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Subjekti paraqet këtë raport, sepse do të aplikojë për leje mjedis Tip B për aktivitetin:

| PRODHIMI I MOBILERIVE | |
|---|---|
| ID 11.1 | Prodhim i mobilieve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjeter në këtë shtojcë. |
| VEPRIMTARI TË TJERA QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E SOLVENTËVE | |
| ID 7.12/I | Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri. |

Klasifikimi referuar Shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, të ndryshuar.

3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT

- Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis (Emetimet në ajër, Gjenerimi i zhurmave; Ndikimi në florë/faunë; Mbetjet e gjeneruara; Ndikimi social-ekonomik; Ndikimi në cilësinë e jetës në qendrat e banuara; Ndikim në peisazhin e zonës).
- Gjetja e alternativave që janë me miqësore me mjedisin dhe propozimi i masave të duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative gjatë zbatimit të aktivitetit.
- Lehtësimi i infomimit të publikut dhe organeve vendim-marrëse mjedisore, lidhur me zbatimin e aktivitetit.

4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në adresën: Durrës, Krujë, Lagja nr.4, rruga Karl Gega, ndërtesë private, 5 kateshe, zona kadastrale nr. 8621, me numer pasurie 4/103 dhe 4/313.

Koordinatat e vendndodhjes së aktivitetit janë si më poshtë:

| Nr. | X | Y |
|-----|------------|------------|
| 1. | 4398721.16 | 4597991.62 |



5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

PRANIMI I LENDES SE PARE NE SUBJEKT.

Lenda e pare do te sigurohet nga furnitore te ndryshem. Pas pranimit te tyre nga personi perjegjes dhe likuidimit, magazinohet ne vendin e percaktuar brenda koordinatave te aktivitetit, per t'u perdonur me pas në proceset e punës. Kompania kujdeset qe cilesia e drurit te jete sa me e mire, pasi ato perdoren per nje kohe te gjate dhe ne kete menyre i jep me shume siguri klienteles per cilesine e produktit qe prodhon dhe tregon.

Lendët e para do te transportohen nepermjet mjeteve te transportit (pirun) ose fizikisht nga punonjësit (kur sasia që do të transportohet nuk është shumë e madhe) ne repartin e magazinimit nga punonjesit perkates te repartit dhe me pas do te shperndahet ne repartet perkates sipas rendit te punes, duke vazhduar ne kete menyre perpunimin e metejshem te tij deri ne realizimin e produktit perfundimtar.

REPARTI I MOBILERISE SE DRURIT

Ne repartin e mobilerise se drurit kryhet shumica e procese te punes, duke filluar qe nga prerja e drurit, dhenia e formes, deri tek prodhimi i produktit final.

Pasi druri merret nga reparti i magazinimit, futet ne procesin e perpunimit te tij brenda repartit te mobilerise, ku seleksionohet sipas madhesise dhe formes per mobiljen perkatese dhe kalon neper sektoret e listuar me poshte, per te arritur deri ne produktin perfundimtar.

Reparti i MOBILERISE SE DRURIT perbehet nga keto sektore:

- Sektori i sharrimit dhe perpunimit,
- Sektorin e zmerilimit te drurit
- Sektori i lyerjes

Sektor i sharrimit dhe perpunimit ka në perberje te tij: Sharra, CNC, trapane etj. Fillimisht druri do të kalohet në prerje, para se ai t'u nënshtrohet proceseve të tjera deri në përfitimin e produktit final. Për këtë qëllim shërben një makineri prerëse, e cila bën të mundur prerjen e tij dhe dhënien e formës së dëshiruar.

Sektori i zmerilimit:

Gjate ketij procesi limohet sipërfaqja e drurit. Pasi druri eshte limuar me leter zmerile, ai do te transportohet nga njëra makineri te tjetra duke vazhduar në këtë mënyrë përpunimin e metejshëm të tij deri në realizimin e produktit përfundimtar.

Sektori i lyerjes:

Në këtë sektor do të aplikohet lyerja e mobiljeve të produhuara.

5.1. Menaxhimi i instalimit

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin në fjalë.

Për zhvillimin e aktivitetit, operatori operon konform të gjithë rregullave teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore.

Puna është organizuar në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organogramë, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrate dhe përgjegjësitë e secilit punonjës. Kjo metodë është efektive për realizimin sa më eficent dhe të suksesshëm të punës.

Pak a shumë hierarkia dhe rrjedha e autoritetit tregohet në këtë skemë të thjeshtë, ku çdo gjë varet drejtpërdrejtë nga Administratori i kompanisë.

ORGANOGRAMA



Për shambahien e aksidenteve nga pajisjet tregohet një kujdes i veçantë nga punonjësit për mirëmbajtjen e gjendjes së tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik.

*****Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë janë në qendër të vëmendjes së operatorit.**

Tabela e mëposhtëme jep informacion mbi kushtet e punës.

| KUSHTET E PUNËS | | | | | |
|--|--|--|--|---------------|----------|
| Numri total i punonjësve | 10 | | | | |
| Shpërndarja e punonjësve | ZYRA | PRODHIMI | MIRËMBAJTJA | MAGAZINIMI | TË TJERA |
| | 2 | 5 | 1 | 2 | - |
| Turnet dhe aktivitetet | Zyrat / administrata | | | Instalimet | |
| | 1 TURN | | | 1 TURN | |
| Orët e punës | Zyrat / administrata | Instalimet | | | |
| | 08⁰⁰-16⁰⁰ → 8 orë | 08⁰⁰-16⁰⁰ → 8 orë | | | |
| Numri i ditëve të punës në vit | 312 | | | | |
| Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllët | Pushimet | | Sipas kodit të punës secilit punonjës i takon 24 ditë/vit pushim. | | |
| | Ndërpërje të rregullta të funksionimit | | Dita e dielë | | |

5.2. Lëndët e para dhe ndihmëse

Aktiviteti në fjalë është një aktivitet prodhimi, i cili kërkon përdorim të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse si më poshtë:

| Lëndë të para | Lëndë/ materiale ndihmëse |
|---------------|---------------------------|
| Lëndë drusore | Ujë |
| Melaminë | Energji Elektrike |
| MDF | Mjete/pajisje pune |
| Kompesatë | ---- |
| Bojëra | ---- |

6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS

| RREZATIMI JONIZUES |
|--|
| Gjatë zhvillimit të aktivitetit, nuk do të gjenerohen rrezatime jonizuese, pasi vetë natyra e aktivitetit nuk shoqerohet me ndikime të tillë. |
| VIBRACIONE |
| Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me vibracione, pasi asnjë pajisje që përdoret në funksion të aktivitetit nuk gjeneron vibrime. |
| NDIKIMET NË POPULLËSI |
| ***Aktiviteti do të zhvillohet brenda vijës së verdhë të zonës urbane Krujë. |
| <p>Përdorimi i tokës (Zonë urbane)</p> <p>Legjende</p> <ul style="list-style-type: none"> Forme geografike Hidrografia Rugë e rrugës administrative Forme geografike Hidrografia Rugë e rrugës administrative <p>Zonë urbane</p> <p>Ujëvara</p> <p>Skala 1:10000</p> <p>0 100 200 300 m.</p> |
| Edhe pse aktiviteti është i pozicionuar në një zonë urbane, në kufizimet e tij zhvillohen aktivitete tregëtare të ndryshme. Natyra e këtij aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime në ujë, ajër dhe tokë që mund të cënojnë mjedisin, apo shëndetin banorëve të cilet banojnë aty pranë. Madje ky aktivitet është një e mirë publike, e cila do t'i shërbejë të gjithë komunitetit të zonës por dhe më tej në aspektin e punësimit. |

NDIKIMET NË KLIMË

***Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.

NDIKIMET NË AJËR

***Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet me shkarkime në ajër të pluhrale dhe gazeve nga mjetet e transportit që do të sjellin lëndën e parë.

Këto shkarkime do të janë pothuajse minimale, sepse në momentin që mjetet do të mbërrijnë në subjekt ato do të qëndrojnë të fikura.


Gjithashtu do të gjenerohen pluhra në repartet e prodhimit gjatë përpunimit të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve. Për reduktimin e kwytre shkarkimeve, subjekti ka instaluar aspiratorë që bëjnë direkt kapjen e pluhrale, duke minimizuar kështu përhapjen e tyre në ajër.

NDIKIMET NË UJËRA

***Zona ku ushtrohet aktiviteti shtrihet mbi pellgun ujëmbajtës të basenit ISHËM.

Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi asig.gov.al, vihet re se zhvillimi i këtij aktiviteti nuk prek burimeve ujore. Sipërfaqja mbi të cilën do të ushtrohet aktiviteti është e pozicionuar në distanca të largëta nga burimet ujore si më poshtë:

- **766.79 m nga Liqeni i Baruneve.**
- **437.82 m nga Liqeni i Pengilës.**




Zhvillimi i aktivitetit në asnjë rast nuk do të shoqërohet me shkarkime në ujërat sipërfaqësorë apo nëntokësorë.

Ujërat nga shërbimet higjieno-sanitare do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës. Produktet larëse që përdoren nga punonjësit e mirëmbajties përlarjen e ambjenteve të brendshme blihen sa më miqësore me mjedisin përlarjen e ambjenteve të brendshme.

NDIKIMET NË TOKË


***Referuar hartës së gjeneruar nga ASIG Geoportal, aktiviteti është i vendosur mbi depozitimet karbonatike të Eocenit, (Pg2) që përfaqësohen nga gelqerorë biomikritikë dhe turbiditikë. Këto depozitime vendosen mbi depozitimet e Kretakut të sipërm, të cilët më tipike janë për zonën e Krujë-Dajtit dhe atë Jonike. Këto gelqerorë janë me strukturë kristaline me ngjyre bezhë të celur, kryesisht organogjene të rikristalizuar, janë kompakte në brendësi dallohen edhe mikroçarje të mbushura me material argjilor (toka të kuqe).



Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ndikojë në ndotje të mjedisit tokësor. Subjekti do të zhvillojë aktivitetin në një sipërfaqe të shtruar me beton, pra gjasat që toka të kontaminohet janë të ulëta. Vlen të theksohet se mbetjet do të menaxhohen në mënyrë mjaft efektive për të mos ndikuar në ndotje të mjedisit tokësor.

NDIKIMET MBI FLORËN DHE FAUNËN

***Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane, në të cilën nuk takohen elementë të spikatur të florës dhe faunës. (referencë Asig Geoportal).



Përreth kësaj zone, hasim bimësi të ulët dhe barishte të ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushtë me mjedisin rrëthues gjithashtu paraqet një larmi biologjike të varfër. Për sa më lart, vlerësohet se zhvillimi i këtij aktiviteti nuk paraqet asnjë ndikim negativ në florë apo faunë.

NDIKIMET NGA ZHURMAT

***Ushtimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet me gjenerim të zhurmave të shkaktuara nga pajisjet operuese..


Ato do t'i nënshtron kontrollit periodik, për të mbajtur nën kontroll mirëfunksionimin e tyre, në mënyrë që mos të bëhen objekt gjenerimi zhurmash jashtë normave të lejuara. Subjekti do të respektojë vlerat e lejuara të zhurmave dhe do të funksionojë brenda fashës orare të përcaktuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr.2, Datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një mjesid të dhënë dhe përfushën e veprimtarive Ekonomike-Shoqërore".

NDIKIMET E AKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT MBI NDËRTIMET, TRASHËGIMINË ARKITEKTIONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

***Aktiviteti që ushton shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashegiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera. Kjo tregon që zona është e lirë për të realizuar këtë aktivitet dhe që zhvillimi i aktivitetit nuk ndikon në këto zona si në përmirësim apo përkeqësimin e tyre.


Duke iu referuar ASIG Geoportal, vërehet një distancë e konsiderueshme e Zonave të Mbrojtura nga sipërfaqja ku do të ushtrohet aktiviteti, përkatësisht:

- 196.11 m nga Peizazhi i Mbrojtur → Krastë-Verjon ;
- 1.16 km nga Parku Kombëtar → Qafshama.



NDIKIMET E AKTIVITETIT NË RRUGËT LOKALE DHE TRANSPORTIN

***Aktiviteti do të ushtronhet në një zonë të përafshur me infrastrukturën rrugore ekzistuese. Shumë pranë vendndodhjes ku do të ushtronhet aktiviteti është e posicionuar Rr.Karl Gega.



Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do ketë ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirëmbajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes sa më të mirë të aktivitetit të tij.

MENAXHIMI I MBETJEVE

Gjatë ushtrimit të aktivitetit do të gjenerohen 2 tipologji mbetjesh si më poshtë:

MBETJE JO TË RREZIKSHME URBANE

Nga zhvillimi i aktivitetit të punonjësve, do të gjenerohen mbetje urbane me kodin **20 01 01; 20 01 02** dhe **20 03 01**. Këto mbetje do të vendosen në kontenierë (kosha) brenda territorit të aktivitetit, për t'u depozituar më pas në vendet e përbashkëta të përcaktuara nga Njesia e Qeverisjes Vendore. Kontenierët do të janë me ngjyra, në mënyrë që mbetjet të ndahan që në burim, gjithashtu ato do të janë të myllur, përfundimisht e aromave të pakëndëshme, sidomos në kohë me temperaturat e larta dhe në kontakt me lagështirën.

MBETJE NGA AKTIVITETI

Mbetjet e gjeneruara nga proceset e punës, do të janë mbetjet e drurit, që do të gjenerohen gjatë dhënies së formës së mobilieve, si dhe mbetje të bojërave, të cilat do të gjenerohen në repartin e lyerjes gjatë procesit të lyerjes.

Këto mbetje fillimisht vendosen në kontenierë të posatshëm ose në fuçi në rastin e bojërave, të ndara sipas kodeve. Kontenieret etiketohen dhe evidentohen dhe në momentin që është arritur kapaciteti i mbetjeve i rënë darkort mes palëve (*gjenerues / mbetjeve - asgjësues / mbetjeve*), ky i fundit njoftohet për të kryer tërheqjen e mbetjeve. Pasi operatori i licensuar i tërheq mbetjet nga ambjentet e zhvillimit të aktivitetit, ai bën të mundur menaxhimin, trajtimin ose asgjësimin përfundimtar të tyre.

7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS

MJEDISI TOKËSOR

- Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të përcaktuara.
- Zbatimi i kushteve teknike dhe standardeve.
- Menaxhimi sa më efektiv i mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e mjedisit tokësor.
- Pastrimi i mjedisit ne rast të shkarkimeve aksidentale.

CILËSIA E AJRIT

- Larja dhe pastrimi i ambjenteve të punës periodikisht.
- Kontroll periodik i pajisjeve që përdoren për aktivitetin.
- Përdorimi i maskave mbrojtëse për fryshtëzimin nga ana e punonjësve.
- Mbajtja fikur e mjeteve të transportit në momentin që do të mbërrijnë në subjekt.

MJEDISI UJOR

- Parandalimi i shkarkimeve me tipologji ndotëse në mjediset ujore.
- Përdorimi i detergjentëve sa më miqësor me mjedisin.

MENAXHIMI I MBETJEVE

- Vendasja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit.
- Diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara.
- Transportimi periodik i mbetjeve jo të rezikshme urbane në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga Njësia Vendore.
- Tërheqja e mbetjeve teknologjike nga operatorë të licensuar.

ZHURMAT

- Operimi brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.
- Respektimi i gjitha rregulloreve gjatë procesit të punës.
- Kontroll periodik i makinerive dhe pajisjeve që përdoren në funksion të aktivitetit, me qëllim reduktimin e mundësisë së gjenerimit të zhurmave prej tyre.
- Lëvizje e ngadaltë dhe e kujdeshme e mjeteve të transportit në ambjentet e aktivitetit.
- Vendasja e tabelave për zbatimin e rregullores në ambjentet e aktivitetit në mënyrë rigorozë.

8. MONITORIMI

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standarde mjedisore që lidhen me të, përfshirë vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe përfshirë vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Plani i monitorimit në mjedis do të konsistojë në:

Do të kryhet monitorimin çdo 6 muaj përfshirë parametrat mjedisore nga Laboratorët e Akredituar dhe do t'i raportojmë ato pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu do të mbajmë edhe kopjet në subjekt dhe do t'i vendosim në dispozicion inspektiveve që mund të ketë.

| Nr. | Elementi i monitorimit | Frekuenca | KUSH? |
|-----|--|--------------------|------------------------------------|
| 1. | Monitorim i cilësisë së ajrit | Çdo 6 muaj | Laborator i Akredituar |
| 2. | Monitorim i zhurmave | Çdo 6 muaj | Laborator i Akredituar |
| 3. | Sasia e mbetjeve të gjeneruara dhe të transferuara | Në varësi të punës | Operatori |
| 4. | Monitorim i gjendjes teknike të pajisjeve operuese | Çdo 1 vit | Operatori ose Teknikë të posatshëm |

“NDERTIM PRODHIM KRUJA” SHPK

Administrator

Ali Kaloshi
[Signature]
Ndertim Prodhim KRUJA
ALI KALOSHI
KRUJA, ALBANIA